

Heshtja institucionale inkurajon në mënyrë aktive ngacmimet seksuale përmes internetit

Viktimat po shtohen ndërsa institucionet në heshtje shemben

DEKLARATË E PËRBASHKËT NGA GRATË AKTIVISTE PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË RAJONIN E BALLKANIT MBI DHUNËN PËRMES INTERNETIT NË BAZË GJINORE

Ne, gra aktiviste për të drejtat e njeriut nga rajoni i Ballkanit, qëndrojmë së bashku dhe në solidaritet me të gjitha gratë viktime të dhunës përmes internetit në bazë gjinore dhe i nxisim autoritetet të vepronë në përputhje me kompetencat e tyre për të hetuar në mënyrë të plotë dhe të shpejtë çështjen e grupeve Telegram (të tilla si Dhoma Ballkanike, Dhoma Publike, Gjevgjeli Hub, Srpska Soba, Smokva dhe të tjera), për të sanksionuar autorët dhe për të mbrojtur viktimat nga viktimizimi i mëtejshëm.

Pikërisht një vit pas paraqitjes së një grupi të tillë në rrjetin Telegram në Maqedoni, i cili përdoret për ngacmime seksuale të vajzave duke postuar foto të tyre pa asnjë pëlqim, në një kontekst pornografik, si dhe të dhëna personale për viktimat, ne dëshmojmë raste të reja të një abuzimi të tillë, jo vetëm në disa vende, por në të gjithë rajonin. Megjithëse administratorët dhe krijuesit e dy prej këtyre grupeve janë arrestuar, ne besojmë se ky është vetëm hapi i parë për të arritur drejtësinë që duhet t'u sigurojmë të gjitha viktimave të këtij lloji të krimit.

Heshtja institucionale dërgon mesazh se dhuna ndaj grave tolerohet, se nuk është e ndëshkueshme, që autorët e krimeve inkurajohen të vazhdojnë sjelljen e tyre dhe se viktimat mbeten të frikësuar, të turpëruara dhe të heshtura. Rastet në Maqedoni, Serbi dhe Kroaci kanë treguar se një numër i vogël i autorëve të veprave penale ndiqen dhe se disa autorë të cilët ndiqen penalisht ndiqen vetëm për krimin e "prodhimit dhe shpërndarjes së pornografisë së fëmijëve", gjë që bën të pamundur mbrojtjen e viktimave të rritura .

Përvojat e grave nga vendet e ish Jugosllavisë, të cilave u kemi ofruar ndihmë juridike falas dhe shërbime të tjera për vite me rradhë, dëshmojnë për mangësi të shumta në zhvillimin e procedurave. Shpesh, gratë që janë abuzuar seksualisht përmes internetit përballen me përgjigje joadekuate nga ana e institucioneve, kjo është arsyeja pse ato nuk i besojnë policisë dhe e shohin raportimin si të kot, për shkak të praktikave të mosveprimit, mosbesimit dhe relativizimit të përvojave të viktimave. Vendosja e sanksioneve dhe paralajmërimeve për kundërvajtje ndaj autorëve, në vend të akuzave penale të dokumentuara dhe të arsyetuara, si dhe zbatimi joadekuat i ndalimeve për afrimin dhe kontaktimin e viktimave, rezulton në dhunë të vazhdueshme, të intensifikuar, shpesh me pasoja të rënda për shëndetin e viktimave, dhe në disa raste edhe me vdekje. Në lidhje me zyrat e prokurorisë, ne vazhdimisht vërejmë fillimin e vonshëm të akuzave, menaxhim joefikas ose neglizhent të procedurave para hetimore dhe hetimore që në të kaluarën kanë rezultuar me sigurimin e vonshëm ose fare të provave përkatëse, si dhe dështimin për të marrë masa ndaj autorit të krimit për të parandaluar vazhdimin e dhunës ndaj viktimave. Të gjitha këto mangësi institucionale janë bërë edhe më të dukshme me shfaqjen e dhunës seksuale dhe ngacmimit të grave në sferën digjitale, për të cilën, megjithëse ndodh masivisht dhe numëron mijëra gra viktime në Ballkan, nuk ka përgjigje adekuate institucionale apo mbështetje publike. Përkundrazi, diskreditimi i përvojave, fajësimi, sikletosja dhe viktimizimi i dyfishtë janë narrativet dominante me të cilat përballen gratë.

Është e qartë se heshtja e institucioneve inkurajon edhe më tej funksionimin e grupeve të tilla në hapësirën digjitale, dhe vajzat vazhdojnë të përballen me rrezik për sigurinë personale, si dhe dinjitet dhe shëndet të dëmtuar. Fatkeqësisht, mënyra më e lehtë për të poshtëruar një vajzë është ta portretizoni atë në një skenar seksual, i cili flet shumë për stigmën e pakapërcyeshme që ende shënon seksualitetin e grave si të turpshëm dhe të pahijshëm, ndërsa viktimat nuk marrin statusin e viktimës, por e një gruaje që "e kërkoi vetë". Kështu, fotografitë e vjedhura, të kombinuara me mizogjininë, komentet seksiste dhe të dhunshme dhe trajtimin e grave si objekte pa integritet, ndjenja, dëshira dhe trauma, flasin për vlerat e rrënjësura mizogjine në rajonin tonë, të cilat duhet adresuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe rrënjësisht. Që problemi të fillojë të zgjidhet, së pari duhet të emërohet. Ky nuk është problem i abuzimit të të dhënave personale, kështu që nuk mund të zgjidhet me një qasje kaq të kufizuar. Ky është një problem i dhunës së bazuar në gjini, që synon poshtërimin, shantazhin, heshtjen dhe shtypjen e vajzave dhe grave, dhe nëse nuk trajtohet si e tillë, autorët e krimit do të kenë sukses në qëllimin e tyre.

Sot jemi të vetëdijshëm/e se ekziston rrjet rajonal i ngacmuesve, dmth hapja dhe administrimi i grupeve ballkanike qëllimi i të cilave është të poshtërojnë dhe ngacmojnë seksualisht gratë. Kjo është arsyeja pse ne kërkojmë nga institucionet kompetente që seriozisht dhe me përgjegjësi t'i qasen këtyre fenomeneve shoqërore që prekin të paktën gjysmën e popullsisë. Ne kërkojmë bashkëpunim institucional ndërkufitar dhe hetim dhe ndjekje të plotë të të gjithë shkelësve të ligjit të përfshirë në rajon.

Ky rast është shans që të gjitha institucionet nga rajoni të tregojnë se ato qëndrojnë për të drejtat e grave dhe i mbrojnë nga dhuna me bazë gjinore, me të vërtet, dhe jo vetëm në mënyrë deklarative! Prandaj, ne kërkojmë nga Zyrat e Prokurorisë Publike në rajon që të sqarojnë menjëherë dhe tërësisht rastet e grupeve Telegram të cilat janë vepër penale. Ne kërkojmë nga Ministrinë e Brendshme që vazhdimisht të ndërmarrin aktivitete parandaluese dhe të ndalojnë funksionin e grupeve të tilla. Nuk duhet të lejojmë një situatë në të cilën viktimat po shtohen, ndërsa institucionet heshtin dhe dështojnë në plotësimin e funksionit të tyre.

Solidaritet!

1. Центар за младински активизам ЦМА КРИК
2. Здружение за дислексија АЈНШТАЈН
3. Здружение за одржлив развој СФЕРА Интернешнал Битола
4. Здружение на граѓани - Младите можат
5. Центар за едукација и развој - ЦЕД
6. Европско здружение на студенти по право - ЕЛСА Македонија
7. Здружение за мултикултурна интеграција Инклузија
8. Здружение на правници ЛЕГАЛ Тинк
9. Регионална ромска образовна младинска асоцијација
10. Здружение СВТ Алумни Скопје
11. Центар за интеркултурен дијалог
12. Фондација за интернет и општество Метаморфозис
13. Здружение на граѓани - Ромаверзитас
14. Лидери за едукација, активизам и развој
15. Креатив
16. Секција на млади на Сојуз на синдикати на Македонија
17. Здружение Станица П.Е.Т. Прилеп

18. Македонско здружение на млади правници
19. Опции за здрав живот - ХОПС / Healthy Options Project Skopje - HOPS
20. Фондација Отворено општество - Македонија (ФООМ)
21. СУБВЕРЗИВЕН ФРОНТ Скопје / Sexual and Gender Minorities Association SUBVERSIVE FRONT Skopje
22. Младински образовен форум - МОФ / Youth Educational Forum - YEF
23. Period. The Menstrual Movement Skopje
24. Здружение на правници Роми
25. Reporting Diversity Network 2.0
26. Хелсиншки комитет за човекови права - Скопје / Helsinki Committee for Human Rights of the Republic of Macedonia
27. Коалиција Маргини / Coalition Margins
28. Здружение на граѓани за промоција на женската активност Тиит! Инк. - Скопје / Tiiit! Inc. - Skopje
29. Здружение за локален и рурален развој / Association for Local and Rural Development
30. ЛезФем / LezFem
31. Организација на жените на општина Свети Николе / Organization of Women of the Municipality of Sveti Nikole
32. Здружение за едукативен развој - Еквалис / Association for Educational Development - Ekvalis
33. Хуманитарно Здружение „Мајка“, Куманово / Humanitarian association "Mother", Kumanovo
34. ТАКТ / ТАКТ - Together Advancing Common Trust
35. Рурална коалиција / Rural Coalition
36. Реактор - Истражување во акција / Reactor - Research in Action
37. Национален совет за родова рамноправност (СОЖМ)
38. Мрежа Стела / Stella Network
39. ХЕРА / Health Education and Research Association, HERA
40. Акција Здруженска / Akcija Zdruzenska
41. Здружение на граѓани за еднакви можности „СЕМПЕР, Битола / "Association of equal opportunities "SEMPER", Bitola
42. Женски Форум Тетово / Women's Forum Tetovo
43. Женска граѓанска иницијатива АНТИКО / Women's Civic Initiative – "ANTICO"
44. Националната Мрежа против насилство врз жените и семејно насилство
45. Здружение за локален развој - Камењане / Association for Local Rural Development - Kamenjane
46. Здружение за промоција на статусот на жените во македонија „Женска акција“, Радивиш / Association for Promotion of the Status of Women in Macedonia "Women's Action", Radovish
47. Здружение на граѓани „СУМНАЛ / "Association of Citizens "SUMNAL"
48. Здружение на граѓани „Флоренс Најтингел“, Куманово / Association of Citizens "Florence Nightingale", Kumanovo
49. Здружение на социјални работници на Град Скопје / Association of Social Workers of the City of Skopje
50. Кризен центар „Надеж“ / Crisis Center "Hope"
51. Здружение на турчинки во Македонија, „ДЕРЈА“ / Organization of Turkish Women in Macedonia, "DERJA"
52. Организација на жени на Град Скопје, ОЖС / Organization of Women of the City of Skopje, OZS
53. Организација на жени „Кумановка“, Куманово / Organization of Women "Kumanovka" , Kumanovo
54. Организација на жени на Општина Велес / Organization of women from the municipality of Veles
55. Женска граѓанска иницијатива „КЛЕА“, Битола / Women's Civic Initiative "KLEA" – Bitola

56. Младински центар за еднакви можности / Youth Center for Equal Opportunities
57. „Една може“ Скопје / “One Can” Skopje
58. Здружение за родова еднаквост „Визија“, Кавадарци / Association for Gender Equality „Vision“, Kavadarci
59. Комора на психолози на Република Северна Македонија / Chamber of Psychologists in Republic of North Macedonia
60. Здружение на жени ромки и млади „Лулуди“ / Roma Women and Youth Association "Luludi"
61. Скај Плус Струмица / Sky Plus Strumica
62. Медуза - феминистичка платформа / Meduza - Feminist platform
63. Women's Rights Center (Centar za ženska prava)
64. Human Right Action (Акција за људска права)
65. ANIMA- Center for Peace Education (ANIMA - Centar za mirovno obrazovanje)
66. SOS Hotline Berane (SOS Telefon Berane)
67. SOS Hotline Podgorica (SOS Hotline Podgorica)
68. Women's Safe House (Sigurna ženska kuća)
69. Association of Youth with Disabilities (Udruženje mladih s hendikepom)
70. NGO Juventas (NVO Juventas)
71. Udruženje "Žene juga" Pirot
72. NVO ASTRA
73. BeFem feministički kulturni centar
74. NVO ATINA
75. Ženska pomoć sada - SOS telefon za žene i djecu žrtve nasilja
76. Kolektiv mladih žena FEMIX
77. Udruženje građana “ Žene za mir”
78. Alternativni centar za devojke
79. Žene u crnom
80. ROZA Udruženje za radna prava žena
81. Rekonstrukcija Ženski fond
82. Ženergija Hub
83. Impuls Tutin
84. Centar za ženske studije, Beograd
85. Incest Trauma Centar - Beograd
86. Kulturni centar DamaD
87. Centar za podršku ženama, kikinda
88. UŽ TEUTA-TIM, TRSTENIK
89. Udruženje građanki FemPlatz
90. Ženski centar Šabac
91. Fondacija CURE- Sarajevo
92. Ženska soba - centar za seksualna prava
93. Romski centar za žene i decu DAJE
94. Centar za žene žrtve rata - ROSA
95. CENTAR ZA PODRŠKU I RAZVOJ CIVILNOG DRUŠTVA "DELFIN"
96. B.a.B.e. Budi aktivna. Budi emancipiran.
97. Ženska udruga IZVOR
98. Udruženje Romkinja Osvit - Niš
99. Udruga žena Romkinja u Hrvatskoj “”Bolja budućnost”
100. Udruga žena Vukovar
101. Ženska grupa Karlovac “Korak”

102. Centar za devojke
103. Sigurna zenska kuca
104. Centar za razvoj zajednice LINK
105. Udruga za ljudska prava i građansku participaciju PaRiter
106. Udruženje žena Peščanik
107. Autonomni ženski centar, Beograd
108. UG " Romani cikna" Kruševac
109. IZ KRUGA - VOJVODINA, Novi Sad
110. SOS za žene i decu žrtve nasilja Vlasotinca
111. Labris - organizacija za lezbejska ljudska prava
112. PAOR- Panonska Antifašistička organizacija
113. Centar za podršku i razvoj civilnog društva "DELFIN"
114. ANIMA Centar za žensko i mirovno obrazovanje
115. Ženski centar Užice
116. Inicijativa Verujem ti
117. Bibija Romski zenski centar
118. Inicijativa Nećemo Prećutati
119. Centar za ženske studije Zagreb
120. Forum žena Prijepolja
121. SOS Rijeka - centar za nenasilje i ljudska prava
122. Udruga žena Nit
123. Sigurna ženska kuća
124. Udruga "HERA" Križevci za zaštitu i promicanje ljudskih prava
125. Ženska mreža BiH
126. UŽ "SEKA" Goražde
127. Fondacija "Lara"
128. IN fondacija
129. Inicijativa Građanke za ustavne promjene
130. Centar ženskih prava
131. Inicijativa građanki/na Mostar
132. Helsinški parlament građana Banjaluka
133. Fondacija Udružene Žene Banja luka
134. Udruženje žena "Priroda" Bratunac
135. NVO "SPES"
136. Udruženje žena Romkinja "Bolja budućnost" Tuzla
137. Ženska romskamreža "Uspjeh" Bosna i Hercegovina
138. Latcho Dive- Association for Roma Women Development - Skopje